



Agjencia Shtetërore
për Mbrojtjen e të
Drejtave të fëmijëve

*Vjetar Statistikor për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve
2016*

2016

#UnëMbrojFëmijët

Përmbajtja

-Hyrje.....	3
-Përshkrim i përgjithshëm për raportin.....	4
- Analiza e mbledhjes së të dhënave.....	

Hyrja

Bazuar në ligjin 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe INSTAT.

Ministritë e Linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT bazuar në VKM Nr. 267 datë 12.04.2012 “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” dërgojnë pranë ASHDMF-së të dhënat statistikore vjetore të mbledhura dhe përpunuara bazuar në formularët bashkëlidhur këtij vendimi dhe periodicitetit të përcaktuar.

Në bazë të raportimeve vjetore të ministrive e linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT është hartuar vjetari statistikor për vitin 2016 me të dhëna numerike mbi situatën e të drejtave të fëmijëve.

Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve për herë të parë përgatit vjetarin statistikor për çështjen e të drejtave të fëmijëve për vitin 2016. Duke ofruar informacion statistikor në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe duke dhënë mundësi që të bëhen krahasime me të dhënat e vitit 2015. Të drejtat që janë pjesë e këtij procesi monitorimi përfshijnë të drejtën për mbrojtje sociale , të drejtën për kujdes shëndetësor, mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik, mbrojtja nga trafikimi dhe çdo formë shfrytëzimi dhe keqtrajtimi seksual dhe të drejtën për arsim.

Vjetari Statistikorë për Çështjet e të Drejtave të Fëmijëve për vitin 2016 është një material që informon një gamë të gjerë përdoruesish që nga grupet e interesit e deri te publiku me informacion statistikor zyrtar në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve. Ky material shërben për të diskutuar në nivel vendor dhe kombëtar politikat mbi fëmijët , si mund të shërbej dhe në zhvillimin e politikave publike e lokale në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës.

- **Mënyra e përpunimit të të dhënave dhe burimi i të dhënave**

Në zbatim të legjislacionit të mësipërm, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me ministritë e linjës/institucionet qendrore dhe INSTAT ka ndërtuar një sistem treguesish të monitorimit që mat periodikisht realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Treguesit e monitorimit janë pjesërisht tregues struktural që reflektojnë ekzistencën e strukturave që mbështesin dhe mundësojnë realizimin e disa prej të drejtave të fëmijëve, dhe nivelin e përfitimeve të shërbimeve nga fëmijët.

Treguesit e monitorimit të të drejtave të fëmijëve tregojnë ndryshimet në grupin e fëmijëve përgjatë gjithë ciklit të fëmijërisë (< 18 vjeç), përqindjen e fëmijëve të varfër, nivelin e mbulimit me shërbime sociale publike dhe private të fëmijëve që kanë nevojë , informacione rreth procesit të birësimeve dhe aspekteve të veçanta të tij , sëmundshmërisë, ushqyerjes, imunizimit, kujdesit antenatal dhe shtatëzanisë/mëmësisë së hershme, njohjen e fenomenit dhe shpërndarjen e tij sipas formave të dhunës (dhunë brenda familjes, shfrytëzime seksual, keqtrajtim, trafikim), numrin e denoncimeve ndaj dhunës, mbi numrin e fëmijëve të përfshirë në vepra penale dhe të natyrës së veprave penale të kryera, peshën që zënë veprat penale të fëmijëve në totalin e veprave penale, si edhe numrin e fëmijëve të dënuar në struktura tradicionale të vuajtjes së dënimit dhe me dënim alternative, përshkruajnë karakteristikat e punës së fëmijëve ekzistencën e punës së paligjshme dhe pjesëmarrjen në programet shkollore , cilësinë e mësimdhënies që shprehet me raportin mësues-nxënës, braktisjen e arsimit të detyruar dhe barazisë gjinore në arsim.

Treguesit janë ndarë në 8 fusha të mëdha dhe 15 nënndarje si më poshtë:

- 1) [Treguesit Demografike](#)
- 2) [Treguesit e Varfërisë për Fëmijët](#)
- 3) [Treguesit e Përkujdeset Social](#)
 - a. Shërbimet Sociale për Fëmijë
 - b. Aftësia e kufizuar
 - c. Kujdestaria
 - d. Birësimi
- 4) [Treguesit e Shëndetësor](#)
 - a. Vdekshmëria
 - b. Sëmundshmëria
 - c. Ushqyerja
 - d. Imunizimi
 - e. Kujdesi për nënën
 - f. HIV/AIDS
 - g. Planifikimi Familjar
- 5) [Treguesit e Dhunës , Trafikimit, dhe Mbrojtjes](#)
 - a. Vetëvrasjet e fëmijëve
 - b. Aksidentet rrugore
 - c. [Trafikimi](#)
 - d. Mbrojtja e Fëmijëve
 - e. Dhuna dhe abuzimi
- 6) [Treguesit e Drejtësisë për të Miturit](#)
- 7) [Treguesit Punësimit të Fëmijëve](#)
- 8) [Treguesit e Arsimimit të Fëmijëve](#)

- **Burimi dhe mbledhja e informacionit**

Të dhënat janë dytësore mblidhen nga ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore sipas treguesve të VKM 267 një herë në vit. Si burime informacioni në nivel qendror shërbejnë institucionet : Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës, Koordinatori Antitrafik, Komiteti i Birësimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Provës dhe INSTAT.

Burim tjetër i rëndësishëm informacioni janë të dhënat e Censurit të Popullsisë 2011, të dhëna e LSMS 2012, të dhëna nga Anketa e Punës së Fëmijëve 2010, dhe të dhëna nga studime për vlerësimin e obezitetit maj 2013, studim për jodizimin 2012. Janë të dhëna të fundit që disponojnë INSTAT dhe Instituti i Shëndetit Publik.

- **Përpunimi i të dhënave dhe i treguesve**

Të dhënat dhe treguesit që mblidhen nga burimet e lartpërmendura janë në njësinë matëse numër dhe përqindje . Treguesit e monitorimit janë të specifikuar sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve.

Të gjitha të dhënat mblidhen dhe përpunohen nga Sektori Koordinim Statistikës dhe ruhen në databazë, në raport të dhënat janë paraqitur në tabela dhe grafik që ndihmojnë për të kuptuar më mirë për të monitoruar dhe krahasuar situatën e të drejtave të fëmijëve në vitet 2015-2016.

Treguesit Demografik

Treguesit demografike tregojnë përqindjen që zënë fëmijët në strukturën e popullësisë, shpërndarja sipas qarqeve, numrin e fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, ose që jetojnë në familje me një prind dhe numrin e familjeve me fëmijë 0-18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike. Janë shtatë tregues dhe informacioni për këto tregues mblidhet nga INSTAT (me të dhëna nga publikimi i popullsisë në shkurt 2017) dhe Shërbimi Social Shtetëror për familjet që mbështetën me ndihmë ekonomike.

1. Numri i fëmijëve sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve


Treguesit demografik të mbledhura nga INSTAT janë siguruar nga publikimi i popullsisë në shkurt 2017. Sipas këtij publikim numërohen 743047 fëmijë në të gjithë vendin . Krahasuar me të dhënat nga Census 2011 që numërohen **827432** fëmijë në të gjithë vendin në vitin 2016-2017 kemi një ulje të numrit të fëmijëve.

Rajoni	1.Numri i femijeve sipas grupmoshes, gjinise dhe qarqeve												
	Totali i femijeve 0-18 vjeç	0-4 vjeç			5-9 vjeç			10-14 vjeç			15-19 vjeç		
		Total	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj
Berat	34279	7524	3646	3878	7358	3522	3836	9153	4392	4761	10244	4896	5348
Dibër	36471	9191	4391	4800	8233	3911	4322	8660	4079	4581	10387	4918	5469
Durrës	72468	17048	8243	8805	15889	7658	8231	18350	8744	9606	21181	10386	10795
Elbasan	76428	17374	8558	8816	16626	7992	8634	19704	9428	10276	22724	10925	11799
Fier	78443	16892	8164	8728	17653	8407	9246	20771	9915	10856	23127	11025	12102
Gjirokastër	16312	3248	1587	1661	3380	1562	1818	4604	2232	2372	5080	2425	2655
Korçë	56681	11239	5431	5808	12842	6137	6705	15378	7275	8103	17222	8271	8951
Kukës	23148	6068	2856	3212	5492	2626	2866	5238	2489	2749	6350	3025	3325
Lezhë	34177	7933	3752	4181	7282	3558	3724	8727	4243	4484	10235	4968	5267
Shkodër	54591	11071	5349	5722	12310	5998	6312	14239	6878	7361	16971	8460	8511
Tiranë	214916	49985	24098	25887	46899	22459	24440	53967	26157	27810	64065	32372	31693
Vlorë	45133	9032	4292	4740	10345	4918	5427	12405	5941	6464	13351	6473	6878
Shqipëri	743047	166605	80367	86238	164309	78748	85561	191196	91773	99423	220937	108144	112793


Përqindja e fëmijëve sipas grupmoshës , gjinisë dhe qarqeve

Sipas të dhënave të publikimit të popullsisë në shkurt 2017 rezulton se 25.8% në shkallë vendi janë fëmijë nga të cilët 12.5% janë femra dhe 13.3 % janë meshkuj. Krahasuar me të dhënat e Censurit 2011 që numërohen 27.8% fëmijë ne vitin 2016-2017 kemi një ulje të % së fëmijëve.

Përqindja e fëmijëve në shkallë vendi



Sipas të dhënave të publikimit të popullsisë në shkurt 2017 rezulton se numri i fëmijëve të grupmoshës 0-4 vjeç 22.4 %, për grupmoshën 5-9 vjeç rezulton 22.1% , për grupmoshën 10-14 vjeç rezulton 25.7 dhe për grupmoshën 15-19 vjeç rezulton 29.7.



2. Numri i familjeve sipas numrit të anëtarëve dhe qarqeve.

Sipas dhënave të Census 2011 rezultojnë 722262 familje gjithsej me nga 1- 4 anëtarë. Numrin më të madhe të familjeve e zënë familje me 2 anëtar 131325 fëmijë dhe numrin më të vogël e zënë familje me 1 anëtar e shprehur në vlerën 4625 familje

Rajoni	Numri i familjeve sipas numrit të anëtarëve dhe qarqeve				
	Gjithsej	1 anëtarë	2 anëtarë	3 anëtarë	4+ anëtarë
Berat	38.493	2.144	8.084	7.714	20.551
Dibër	29.573	977	3.058	3.854	21.684
Durrës	66.65	3.696	11.336	11.546	40.072
Elbasan	73.044	3.64	11.318	12.604	45.482
Fier	82.074	4.202	16.456	15.615	45.801
Gjirokastrë	21.287	1.946	5.37	4.301	9.67
Korçë	60.171	4.512	12.438	11.073	32.148
Kukës	17.126	481	1.595	1.92	13.13
Lezhë	32.236	1.649	5.582	5.02	19.985
Shkodër	54.429	4.034	10.352	8.79	31.253
Tiranë	196.218	14.032	33.344	37.945	110.897
Vlorë	50.961	4.937	12.392	9.395	24.237
Shqipëri	722.262	46.25	131.325	129.777	414.91

Shënim: Të dhëna i referohen rezultateve të Census 2011, pasi INSTAT nuk disponon të dhëna të tilla mbas këtij viti.

3. Numri i familjeve me fëmijë 18 vjeç të ndarë sipas numrit të fëmijëve

Sipas të dhënave të Census 2011 rezulton se numrin i familjeve më fëmijë 18 vjeç është i barabartë me familjet me një fëmijë dhe për familjet me dy fëmijë e shprehur në vlerën **158101** dhe numrin më të vogël e zënë familjet me 11 fëmijë e shprehur në vlerën 4.

Rajoni	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4 fëmijë	5 fëmijë	6 fëmijë	7 fëmijë	8 fëmijë	9 fëmijë	10 fëmijë	11 fëmijë
Berat	8620	8620	2757	423	72	17	4	1	0	0	1
Dibër	7352	7352	4517	1567	421	117	27	7	2	2	0
Durrës	15216	15216	6365	1473	281	70	23	6	4	0	1
Elbasan	17560	17560	7040	1529	331	79	25	3	2	1	0
Fier	18930	18930	6442	1125	187	36	7	3	2	0	0
Gjirokastrë	3811	3811	1013	168	29	8	0	0	0	0	0
Korçë	13431	13431	3457	546	105	20	6	2	2	0	0
Kukës	3926	3926	3042	1503	468	171	51	16	5	1	0
Lezhë	7003	7003	3791	1076	262	76	21	3	3	1	0
Shkodër	10475	10475	5882	1956	509	139	31	9	4	0	0
Tiranë	42145	42145	14548	3187	700	153	47	13	9	5	2
Vlorë	9632	9632	3494	591	83	14	4	0	0	0	0
Shqipëri	158101	158101	62348	15144	3448	900	246	63	33	10	4

Shënim: Të dhënat i referohen rezultateve të Census 2011, pasi INSTAT nuk disponon të tilla të dhëna mbas këtij viti.

4. Numri i familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike

Për vitin 2016 numërohen 59918 familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike. Krahasura me vitin 2015 që numërohen 43940 , në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike që numërohen 59918 familje. Numri më i madh i familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike është në rajonin e Elbasanit që numërohen 15311 familje dhe numri më i vogël i familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike është në rajonin e Vlorës që numërohen 863 familje.

Në vitin 2014 u zbatua pilotimi i skemës së re të NE, e cila synon të përmirësoj barazinë dhe efikasitetin e Ndhmës Ekonomike dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në reduktimin e varfërisë dhe vulnerabilitetin. Skema e re ndihmës ekonomike ka gjetur zbatim nëpërmjet përdorimit të formulës së pikëzuar për targetimin dhe mbulimin më të mirë të familjeve më të varfra.

Rajoni	4.Numri i familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike,sipas qarqeve
Berat	961
Dibër	9604
Durrës	908
Elbasan	15311
Fier	1445
Gjirokastër	1300
Korçë	4820
Kukës	8858
Lezhë	3243
Shkodër	6718
Tiranë	5887
Vlorë	863
Shqipëri	59918

5. Numri i fëmijëve nën 18 vjeç që jetojnë me një prind sipas qarqeve

Sipas të dhënave të Censurit 2011 numërohen **47580** fëmijë nën 18 vjeç që jetojnë me një prind në nivel kombëtar. Numri më i madh i fëmijëve nën 18 vjeç që jetojnë me një prind është në qarkun e Tiranë e shprehur në vlerën 12009 fëmijë dhe numri më i vogël është në qarkun e Gjirokastrës e shprehur në vlerën 786 fëmijë.

Rajoni	Numri i fëmijëve nën 18 vjeç që jetojnë me një prind sipas qarqeve
Berat	2542
Dibër	2280
Durrës	5426
Elbasan	5468
Fier	5821
Gjirokastrë	786
Korçë	2830
Kukës	1351
Lezhë	2798
Shkodër	3420
Tiranë	12009
Vlorë	2849
Shqipëri	47580

Shënim: Të dhënat i referohen rezultateve të Census 2011, pasi INSTAT nuk disponon të dhëna të tilla mbas këtij viti

6. Numri i familjeve me fëmijë të moshës 0-18 vjeç, me kryefamiljar gra që mbështeten me ndihmë ekonomike

Për vitin 2016 numërohen 7346 familje me fëmijë të moshës 0-18 vjeç, me kryefamiljar gra që mbështeten me ndihmë ekonomike. Krahasuar me vitin 2015 që numërohen 5403 familje me fëmijë të moshës 0-18 vjeç me kryefamiljar gra që mbështeten me Ndhimë Ekonomike, në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të familjeve me fëmijë të moshës 0-18 vjeç, me kryefamiljar gra që mbështeten me ndihmë ekonomike numërohen 7346 familje.

Rajoni	6.Numri i familjeve me fëmijë të moshës 0-18 vjeç,me kryefamiljar gra që mbështeten me ndihmë ekonomike sipas qarqeve
Berat	146
Dibër	1001
Durrës	138
Elbasan	1342
Fier	455
Gjirokastër	271
Korçë	580
Kukës	615
Lezhë	602
Shkodër	986
Tiranë	1037
Vlorë	173
Shqipëri	7346

7. Numri i fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që vazhdojnë arsimin e detyruar dhe jetojnë në familje që trajtohen me NE

Përvitin 2016 numërohen 59890 fëmijë të moshës 6-15 vjeç që vazhdojnë arsimin e detyruar dhe jetojnë në familje me Ndhmë Ekonomike. Krahasuar me vitin 2015 që numërohen 49992 fëmijë, në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që vazhdojnë arsimin e detyruar dhe jetojnë në familje që trajtohen me Ndhmë Ekonomike numërohen gjithsej 59890 fëmijë.

Rajoni	7.Numri i fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që vazhdojnë arsimin e detyruar dhe jetojnë në familje që trajtohen me Ndhmë Ekonomike
Berat	903
Dibër	15122
Durrës	916
Elbasan	9287
Fier	1892
Gjirokastrë	850
Korçë	3798
Kukës	10243
Lezhë	3445
Shkodër	4849
Tiranë	7787
Vlorë	798
Shqipëri	59890

Si rezultat të ndryshimeve të parashikuara në skemën e re të Ndhmës Ekonomike , e cila ka pasur si qëllim vlerësimin efektiv të fëmijëve dhe familjeve të varfra përfitues të NE , pagesa shtesë dhe subvencioneve në zbutjen e varfërisë së familjeve me fëmijë për ndjekjen e shkollës dhe vaksinimin e fëmijëve të familjeve përfituese. Ndryshimet e reja në legjislacionin e Ndhmës Ekonomike synojnë mbështetjen e fëmijëve në familjet e varfëra, nëpërmjet një pagesë shtesë 300 lekë në muaj gjatë periudhës që ndjekin shkollën dhe 100 lekë për çdo vaksinë të kryer sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit

Treguesit e Varfërisë për Fëmijët

Treguesit e varfërisë për fëmijë janë gjashtë tregues , të dhëna për këto tregues mblidhen nga INSTAT. Të dhënat e treguesve i referohen rezultateve të anketës LSMS 2012. Të dhënat mblidhen nga INSTAT. Në sistemin e treguesve të monitorimit treguesi i përqindjes së fëmijëve të varfër i referohet varfërisë absolute. Varfëria konsiderohet si privim i mirëqenies së fëmijëve dhe tregon pamundësinë e familjeve me fëmijë < 18 vjeç për të plotësuar nevojat bazë të fëmijës për shkak të mungesës së të ardhurave dhe mungesës së aksesit ndaj shërbimeve baze.

1.Përqindja e fëmijëve të varfër (nën18 vjeç) ndaj numrit të fëmijëve gjithsej sipas gjinisë, Urban/rural dhe gjinisë së kryefamiljarit

Sipas LSMS 2012 numërohen në total kryefamiljar femra dhe kryefamiljar meshkuj urban /rural **20.1%**, nga të cilët **20.5 %** janë femra , **19.6** meshkuj, **18.9%** urban dhe **21.2%** rural


Shqipëri	Përqindja e fëmijëve të varfër ndaj numrit të fëmijëve gjithsej sipas gjinisë,urban/rural,gjinisë së kryefamiljarit																	
	Kryefamiljar Femër									Kryefamiljar Mashkull								
	Urban+Rural			Urban			Rural			Urban+Rural			Urban			Rural		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
LSMS 2012	17.0	14.7	19.1	12.6	13.0	12.2	20.4	16.1	24.3	20.4	21.1	19.7	19.4	21.1	17.7	21.3	21.1	21.6

Përqindja në total të kryefamiljareve femra dhe kryefamiljar meshkuj , urban dhe rural.

Shqipëri LSMS 2012	Përqindja e fëmijëve të varfër ndaj numrit të fëmijëve gjithsej sipas gjinisë,urban/rural,gjinisë së kryefamiljarit								
	Gjithsej (K/f Femra+K/f Meshkuj)								
	Gjithsej (Urban+Rural)			Urban			Rural		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
	20.1	20.5	19.6	18.9	20.5	17.3	21.2	20.6	21.8

2.Shkalla e varfërisë absolute sipas grupmoshave dhe gjinisë

Termi “*varfëri absolute*” përcakton një shkallë të rënde deprivimi nga nevojat bazë njerëzore që janë ushqimi, uji , higjiena personale, veshja, strehimi, shërbimi shëndetësor, dhe arsimimi. Sipas të dhënave të LSMS 2012 vlera e shkallës së varfërisë absolute për këto grupmosha është 0-4 vjeç 21.9%, 5-9 vjeç 21.9%, 10-14 vjeç 19.9%, 15-17 vjeç 16.5%.



3. Shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë

Sipas rezultateve të LSMS 2012 shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë shprehet në këto vlera **14.3 %** gjithsej nga të cilët **14.44%** meshkuj dhe **14.2%** femra.

Shqipëri	Shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë		
	Total	Femra	Meshkuj
LSMS 2012	14.3	14.4	14.2

4. Shkalla e varfërisë absolute sipas nivelit arsimor të kryefamiljarit

Nga rezultate e LSMS 2012 përqindja më e madhe e shkallës së varfërisë absolute është e prezent tek kryefamiljarët me asnjë nivel arsimore e shprehur në vlerën 25.2% dhe përqindja më e vogël e shkallës së varfërisë absolute është e prezent tek kryefamiljarët me arsim të lartë e shprehur në vlerën 2.4%.

Shqipëri	Shkalla e varfërisë absolute sipas nivelit arsimor të kryefamiljarit			
	Asnjë	Arsim fillor	Arsim i mesëm	Arsim i lartë
LSMS 2012	25.2	18.5	10.7	2.4

5. Shkalla e varfërisë absolute sipas zonës urbane/rurale.

Nga rezultate e LSMS 2012 shkalla e varfërisë absolute sipas zonës urbane/rurale gjithsej urban+rural e shprehur në vlerën 14.3% nga të cilët 13.3% urbane dhe 15.5% rural

Shqipëri	Shkalla e varfërisë absolute sipas zonës urbane/rurale		
	Total	Urbane	Rurale
LSMS 2012	14.3	13.3	15.5

6. Shkalla e varfërisë absolute sipas numrit të fëmijëve në familje.

Nga rezultate e LSMS 2012 shkalla e varfërisë absolute sipas numrit të fëmijëve në familje shprehet në përqindje me të lartë në familje me 4+ fëmijë në vlerën 51.3% dhe në përqindje më të ulët në familje me një fëmijë e shprehur në vlerën 12.4%.

Shqipëri	Shkalla e varfërisë absolute sipas numrit të fëmijëve në familje			
	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4+ fëmijë
LSMS 2012	12.4	15.6	26.3	51.3

Treguesit e Përkujdesit Social

Treguesit e përkujdesit social janë pesëmbëdhjetë tregues që mblidhen nga Shërbimi Social Shtetëror një herë në vit. Treguesit e përkujdesit social masin nivelin e mbulimit me shërbime sociale publike dhe private të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime sociale.

1 .Llojet e shërbimeve për fëmijë rezidenciale dhe ditore sipas qarqeve.

Institucionet e Përkujdesit Shoqëror ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë që janë jetim biologjike dhe jetim social. Këto institucione janë publike dhe jo publike. IPSH-të publike financohen nga shteti nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ose bashkive dhe menaxhohen në nivel qendror dhe lokal. *Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të cilat administrohen nga Shërbimi Social Shtetëror janë Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç "Hanna dhe Rozafa" Tiranë , Shtëpia e Fëmijës 6-18 vjeç "Zyber Hallulli" Tiranë dhe Shtëpia e Fëmijës parashkollor 3-6 vjeç Shkodër .*

Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të cilat administrohen nga Bashkitë janë Shtëpia e Fëmijës 0-3 vjeç Shkodër, Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Vlorë, Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Korçë, Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Durrës, Shtëpia e Fëmijës 6-18 vjeç Shkodër dhe Shtëpia e Fëmijës 6- 18 vjeç Sarandë.

Nga raportimet e Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2016 ekzistojnë në total :

- **73** qendra rezidenciale+ditore publike dhe jopublike, nga të cilat (17 janë Publike +47 janë Jopublike)
- **27** qendra rezidenciale publike dhe jopublike, nga të cilët (9 publike +18 jopublike)
- **37** ditore nga të cilat (8 ditore publike +29 ditore Jopublike)

Rajoni	1. Shërbimet për fëmijë rezidenciale dhe ditore sipas qarqeve								
	Gjithsej (Rezidenciale+Ditore)			Rezidenciale			Ditore		
	Total	Publike	Jo Publike	Total	Publike	Jo Publike	Total	Publike	Jo Publike
Berat	1	0	1	0	0	0	1	0	1
Dibër	1	0	1	0	0	0	1	0	1
Durrës	8	3	5	3	1	2	5	2	3
Elbasan	9	2	7	4	0	4	5	2	3
Fier	2	0	2	0	0	0	2	0	2
Gjirokastrë	1	0	1	1	0	1	0	0	0
Korçë	8	1	7	4	1	3	4	0	4
Kukës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhë	8	0	8	2	0	2	6	0	6
Shkodër	14	5	9	5	3	2	9	2	7
Tiranë	18	3	6	6	2	4	3	1	2
Vlorë	3	3	0	2	2	0	1	1	0
Shqipëri	73	17	47	27	9	18	37	8	29

2. Numri i fëmijëve që përfitojnë shërbime sociale sipas llojit të shërbimit rezidencial, ditor sipas qarqeve.

Për vitin 2016 numërohen në total 2842 fëmijë që përfitojnë shërbim rezidencial dhe ditor publik dhe jopublik nga të cilët **479** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale + ditore publike dhe **2363** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale + ditore jopublike.

Nga 2842 fëmijë që përfitojnë shërbim rezidencial dhe ditor publik dhe jopublik:

- **525** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike nga të cilët **179** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale publike dhe **346** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale jopublike.
- **2328** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore publike dhe jopublike nga të cilët **300** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore publike dhe **2028** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore jopublike

Numri më i madh i fëmijë që përfitojnë shërbime është në qendrat qendrat rezidenciale+ ditore jopublike se sa në ato publike që numërohen gjithsej 2363 fëmijë , ndërsa në qendrat rezidenciale dhe ditore publike përfitojnë gjithsej 479 fëmijë.

Krahasur me vitin 2015 që numërohen 2826 fëmijë që përfitojnë shërbim rezidencial dhe ditor publik dhe jopublik në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve + 16 fëmijë më shumë se në vitin 2015 që përfitojnë shërbim rezidencial dhe ditor publik dhe jopublik gjithsej 2842.

Për vitin 2015 numërohen **2826** fëmijë që përfitojnë shërbim rezidencial + ditor publik dhe jopublik nga të cilët **479** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale + ditore publike dhe **2347** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale + ditore jopublike.

Nga 2826 fëmijë për vitin 2015:

- **452** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike nga të cilët **296** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale publike dhe **156** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale jopublike.

- **2374** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore publike dhe jopublike nga të cilët **183** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore publike dhe **2191** fëmijë përfitojnë shërbim në qendrat ditore jopublike

Rajoni	2. Numri i fëmijëve që përfitojnë shërbime sociale sipas llojit të shërbimit rezidencial, ditor sipas qarqeve								
	Gjithsej (Rezidenciale+Ditore)			Rezidenciale			Ditore		
Berat	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Durrës	564	165	399	84	18	66	480	147	333
Elbasan	547	135	412	70	0	70	488	135	353
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjirokastër	13	0	13	13	0	13	0	0	0
Korçë	196	19	177	46	19	27	150	0	150
Kukës	9	9	0	0	0	0	9	9	0
Lezhë	362	0	362	29	0	29	333	0	333
Shkodër	896	40	856	60	40	20	836	0	836
Tiranë	182	61	121	182	61	121			
Vlorë	73	50	23	41	41	0	32	9	23
Shqipëri	2842	479	2363	525	179	346	2328	300	2028

3. Numri i institucioneve për fëmijë të ndarë publike, jopublike sipas qarqeve

Sipas raportimeve të Shërbimit Social Shtetëror në të gjithë vendin ekzistojnë në total 68 institucione publike /jopublike rezidenciale ditore/komunitare dhe qendra zhvillimi për personat me aftësi të kufizuar nga të cilat; 21 janë institucione publike dhe 47 institucione jopublike, 27 janë institucione rezidenciale (9 publike+18 Jo publike) dhe 28 janë ditore/ komunitare (5 publike+ 23 jopublike) dhe 13 janë qendra zhvillimi për PAK (7 publike+6 jopublike)

Rajoni	3. Numri i institucioneve për fëmijë të ndarë publike,jopublike sipas qarqeve											
	Gjithsej(Rezidencial publik/jopublik)			Rezidenciale			Ditore/Komunitare			Qendra Zhvillimi per PAK		
	TOTAL	Publike	Jo Publike	TOTAL	Publike	Jo Publike	TOTAL	Publike	Jo Publike	TOTAL	Publike	Jo Publike
Berat	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Durrës	11	4	7	3	1	2	7	2	5	1	1	0
Elbasan	9	1	8	4	0	4	5	1	4	0	0	0
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjirokastër	1	0	1	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Korçë	7	2	5	4	1	3	2	0	2	1	1	0
Kukës	1	1	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0
Lezhë	6	2	4	2	0	2	4	0	4	0	0	0
Shkodër	18	4	14	5	3	2	7	0	7	6	1	5
Tiranë	8	3	5	6	2	4				2	1	1
Vlorë	5	2	3	2	2	0	2	1	1	1	1	0
Shqipëri	68	21	47	27	9	18	28	5	23	13	7	6

4. Numri i fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale publike, jopublike, sipas lloji të institucionit.

Për vitin 2016 numërohen 703 fëmijë në total të vendosur në të gjithë institucionet e përkujdesit social publike jopublike, Qendra Zhvillimi, Qendra pritëse për viktimat e trafikimit dhe Qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje nga të cilët :

- **248** fëmijë janë të vendosur në institucionet publike
- **455** fëmijë janë të vendosur në institucionet jopublike
- **525** fëmijë janë të vendosur në institucione rezidenciale publike dhe jopublike nga të cilët (179 fëmijë në institucionet publike + 346 fëmijë në institucionet jopublike)
- **62** fëmijë janë të vendosur në institucionet rezidenciale të zhvillimit (46 fëmijë në institucionet publike+16 fëmijë në institucionet jopublike)
- **41** fëmijë janë të vendosur në Qëndrat pritëse për viktimat e trafikimit (5 fëmijë në institucionet publike+36 fëmijë në institucionet jopublike)
- **75** fëmijë janë të vendosur në Qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje (18 fëmijë në institucionet publike+57 në institucionet jopublike)

Numri më i madh i fëmijëve janë të vendosur në institucionet të përkujdesit social jo publike , qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje jo publike dhe qendra pritëse për viktimat e trafikimit jo publike gjithsej numërohen 455 fëmijë dhe 248 fëmijë janë të vendosur në të gjitha institucione të përkujdesit social jo publik.

Rajoni	4. Numri i fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale publike, jopublike, sipas lloji të institucionit														
	Total (të gjitha institucionet)			Institucion rezidencial për fëmijë			Institucion rezidencial zhvillimi			Qendra pritëse për viktimat e trafikimit			Qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje		
	Publike+Jo Publike	Publike	Jo Publike	Publike+Jo Publike	Publike	Jo Publike	Publike+Jo Publike	Publike	Jo Publike	Publike+Jo Publike	Publike	Jo Publike	Publike+Jo Publike	Publike	Jo Publike
Berat	17	1	16	0	0	0	17	1	16	0	0	0			
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Durrës	119	43	66	84	18	66	25	25	0	0	0	0			
Elbasan	76	0	76	70	0	70	0	0	0	13	0	13	3		3
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Gjirokastrë	13	0	13	13	0	13	0	0	0	0	0	0			
Korçë	46	19	27	46	19	27	0	0	0	0	0	0			
Kukës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
Lezhë	29	0	29	29	0	29	0	0	0	0	0	0			
Shkodër	63	20	43	60	40	20	3	3	0	0	0	0			
Tiranë	277	93	184	182	61	121	9	9	0	14	5	9	72	18	54
Vlorë	63	49	14	41	41	0	8	8	0	14	0	14	0	0	0
Shqipëri	703	225	468	525	179	346	62	46	16	41	5	36	75	18	57

Krahasuar me vitin 2015 që numërohen 701 fëmijë në total që janë vendosur në të gjithë institucionet e përkujdesit social publike jopublike, Qendra Zhvillimi publike /jopublike, Qendra pritëse për viktimat e trafikimit publike, Qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje publike, në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve 2 fëmijë me shumë të vendosur në të gjithë këto institucionet që numërohen 703 fëmijë

Për vitin **2015** numërohen **701** fëmijë në total që janë vendosur në të gjithë institucionet e përkujdesit social publike jopublike, Qendra Zhvillimi publike /jopublike, Qendra pritëse për viktimat e trafikimi publike /jopublike t, Qendra pritëse e viktimave të dhunës në familje publike /jopublike nga të cilët **519** fëmijë janë të vendosur në institucionet publike dhe **182** fëmijë janë të vendosur në institucionet jopublike.

- **452** fëmijë janë të vendosur në institucione rezidenciale nga të cilët (**296** fëmijë në institucionet publike+**156** fëmijë në institucionet jopublike)
- **48** fëmijë janë të vendosur në institucionet rezidenciale të zhvillimit(**22** fëmijë në institucionet publike+ **26** fëmijë në institucionet jopublike)
- **11** fëmijë janë të vendosur në Qëndrat pritëse për viktimat e trafikimit publike
- **34** fëmijë janë të vendosur në Qendrat pritëse e viktimave të dhunës në familje publike

5.Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike e private, sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve

Për vitin 2016 numërohen 525 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç gjithsej që janë në institucionet rezidenciale publike dhe / jopublike nga të cilët:

- 72 fëmijë janë të grupmoshës 0-3 vjeç
 - 62 fëmijë janë të grupmoshës 3-6 vjeç
 - 391 fëmijë janë të grupmoshës 6-18 vjeç
-
- 179 janë fëmijë në institucionet rezidenciale publike nga të cilët:(57 fëmijë të grupmoshës 0-3 vjeç + 30 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç+ 92 fëmijë të grupmoshës 6-18 vjeç)
 - 346 janë fëmijë në institucionet rezidenciale jopublike nga të cilët:(15 fëmijë të grupmoshës 0-3 vjeç+ 32 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç+ 299 fëmijë të grupmoshës 6-18 vjeç)

Numri më i madh i fëmijëve të grupmoshës 0-18 vjeç janë në institucionet rezidenciale jopublike që numërohen gjithsej 346 fëmijë dhe më i vogël në institucionet publike që numërohen 179 fëmijë.

Krahasur me vitin 2015 që numërohen 452 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç gjithsej që janë në institucionet rezidenciale publike dhe / jopublike në vitin 2016 kemi rritje të numrit të fëmijëve të kësaj grupmoshë në këto institucione.

Rajoni	5.Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike e private, sipas grupmoshës, gjinisë dhe qarqeve											
	Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale (Gjithsej)				Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale Publike				Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale Jo Publike			
	Gjithsej	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-18 vjeç	Gjithsej	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-18 vjeç	Gjithsej	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-18 vjeç
Berat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Durrës	84	16	11	57	18	13	5	0	66	3	6	57
Elbasan	70	7	6	57	0	0	0	0	70	7	6	57
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjirokastër	13	4	5	4	0	0	0	0	13	4	5	4
Korçë	46	9	11	26	19	9	10	0	27	0	1	26
Kukës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhë	29	1	4	24	0	0	0	0	29	1	4	24
Shkodër	60	5	7	47	40	5	7	27	20	0	0	20
Tiranë	182	25	16	142	61	25	6	31	121	0	10	111
Vlorë	41	5	2	34	41	5	2	34	0	0	0	0
Shqipëri	525	72	62	391	179	57	30	92	346	15	32	299

Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike/jopublike sipas gjinsë:

Për vitin 2016 numri i fëmijëve në të gjitha institucionet publike dhe jopublike është 525 fëmijë nga të cilët 288 janë femra dhe 237 janë meshkuj. 179 fëmijë janë të vendosur në institucionet rezidenciale publike nga të cilët 79 janë femra dhe 100 janë meshkuj. 346 fëmijë janë vendosur në institucionet jopublike nga të cilët 209 janë femra dhe 137 janë meshkuj.

Rajoni	Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale (Gjithsej) sipas gjinisë			Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale Publike sipas gjinisë			Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale Jo Publike sipas gjinisë		
	Gjithsej (F+M)	Femra	Meshkuj	Gjithsej (F+M)	Femra	Meshkuj	Gjithsej (F+M)	Femra	Meshkuj
Berat	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Durrës	84	49	35	18	6	12	66	43	23
Elbasan	70	43	27	0	0	0	70	43	27
Fier	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjirokastrë	13	4	9	0	0	0	13	4	9
Korçë	46	25	21	19	8	11	27	17	10
Kukës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhë	29	20	9	0	0	0	29	20	9
Shkodër	60	34	26	40	18	22	20	16	4
Tiranë	182	96	86	61	30	31	121	66	55
Vlorë	41	17	24	41	17	24	0	0	0
Shqipëri	525	288	237	179	79	100	346	209	137

Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike/jopublike sipas etnisë

Për vitin 2016 numëohen 137 fëmijë janë rome/egjiptian në të gjithë institucionet rezidenciale publike dhe jopublike nga të cilët 82 fëmijë janë në institucionet publike dhe 55 fëmijë janë në institucionet jopublike.

Rajoni	Numri i femijeve Rome/Egjiptianë në institucionet rezidencial publike dhe Jopublike		
	Gjithsej	Publike	Jo Publike
Berat	0	0	0
Dibër	0	0	0
Durrës	9	9	0
Elbasan	13	0	13
Fier	0	0	0
Gjirokastrë	4	0	4
Korçë	17	4	13
Kukës	0	0	0
Lezhë	4	0	4
Shkodër	22	22	0
Tiranë	48	28	20
Vlorë	20	19	1
Shqipëri	137	82	55

6.Numri i fëmijëve që kanë hyrë në vitin 2016 në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike sipas grupmoshës dhe gjinisë

Për vitin 2016 pranë institucioneve të përkujdesit sociale publike dhe jopublike kanë hyrë 272 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç nga të cilët:

- 68 fëmijë kanë hyrë në institucionet rezidenciale publike
- 61 fëmijë kanë hyrë në institucionet rezidenciale jopublike.
- 5 fëmijë kanë hyrë Qendra ZHvillimi Rezidenciale
- 43 fëmijë kanë hyrë në Qendrat pritëse e viktimave të dhunës në familje publike
- 31 fëmijë kanë hyrë në Institucione Jopublike që strehojnë viktima të dhunës
- 13 fëmijë kanë hyrë në Qendra Kombëtare e viktimave të trafikimit publik
- 51 fëmijë kanë hyrë në vitin 2016 në Qendrën Kombëtare e Viktimave të trafikimit (Jopublik)

Në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve që kanë hyrë në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike ,krahasuar me vitin 2015 që numërohen 168 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç që kanë hyrë në institucionet e përkujdesit social publik dhe jo publik nga të cilët:

- 31 fëmijë kanë hyrë në institucionet rezidenciale publike
- 38 fëmijë kanë hyrë në institucionet rezidenciale jopublike.
- 3 fëmijë kanë hyrë Qendra ZHvillimi Rezidenciale
- 34 fëmijë kanë hyrë në Qendrat pritëse e viktimave të dhunës në familje publike
- 31 fëmijë kanë hyrë në Qendra Kombëtare e viktimave të trafikimit publik
- 51 fëmijë kanë hyrë në Qendrën Kombëtare e Viktimave të trafikimit (Jopublik)

INSTITUCIONET	6. Numri i fëmijëve që kanë hyrë në vitin 2016 në institucionet rezidenciale publike e private, Qendra Zhvillimi publike/Jopublike, Qendra pritese e viktimave të dhunës publike jopublike, Qendra kombetare të viktimave të trafikimit publike dhe Jopublike sipas grupmoshës dhe gjinisë						
	Grupmosha				Gjinia		
	Gjithsej	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-18 vjeç	Gjithsej (F+M)	Femra	Meshkuj
INSTITUCIONE REZIDENCIALE PUBLIKE PER FEMIJE (0-18 vjeç)	68	32	7	29	68	35	33
INSTITUCIONE JOPUBLIKE PER FEMIJE(0-18 vjeç)	61	10	10	41	61	34	27
QENDRA ZHVILLIMI REZIDENCIALE PUBLIKE PER FEMIJE PAK	5						
QENDRA ZHVILLIMI REZIDENCIALE JOPUBLIKE PER FEMIJE PAK	0	0	0	0	0	0	0
Qendra pritese e viktimave të dhunës në familje (publike)	43	13	15	15	43	19	24
Institucione Jopublike që strehojnë viktimë të dhunës	31	8	8	15			
Qendra Kombetare e viktimave të trafikimit (publik)	13	1	1	11	13	11	2
QENDRA KOMBETARE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT(Jopublik)	51	12	7	32	39	37	2

7. Numri i fëmijëve që kanë dalë në vitin 2016 nga institucionet rezidenciale publike dhe jo publike sipas grupmoshës , gjinisë dhe arsyes së largimit.

Ky tregues kërkon numrit total të fëmijëve që kanë dalë gjatë një viti (nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor) nga strukturat rezidenciale publike dhe private sipas grupmoshës dhe arsyes së largimit (kthimi në familje dhe birësim). Ky tregues mat fluksin e fëmijëve në nevoje që dalin nga strukturat rezidenciale për fëmije në një vit të caktuar.

Për vitin 2016 nga institucionet rezidenciale të përkujdesit social publike/jopublike kanë dalur 248 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjec nga të cilët 144 fëmijë janë kthyer në familje, 83 janë birësuar dhe 21 fëmijë janë transferuar në institucione të tjera.

Nga institucionet rezidenciale publike kanë dalur 73 fëmijë sipas këtyre arsyeve:

Sipas arsyes:

- Kthim në familje: 49 fëmijë
- Birësim : 24 fëmijë

Nga institucionet rezidenciale jopublike kanë dalur 56 fëmijë sipas këtyre arsyeve:

Sipas arsyes:

- Kthim në familje: 46 fëmijë
- Birësim : 6 fëmijë
- Transferim në institucion tjetër 4 fëmijë

Nga Qendra Zhvillimi Publik për personat me Aftësi të Kufizuar 25 fëmijë sipas këtyre arsyeve

Sipas arsyes:

- Kthim në familje: 14 fëmijë
- Transferim në institucion tjetër 11 fëmijë

Nga Qendra Pritëse e Viktimave të Dhunës në familje Publike kanë dalur 45 fëmijë sipas këtyre arsyeve

Sipas arsyes:

- Birësim : 43 fëmijë

- Transferim në institucion tjetër: 2 fëmijë

Nga Qendra Kombëtare e viktimave të trafikimit (publike) kanë dalur 13 fëmijë sipas këtyre arsyeve

Sipas arsyes:

- Birësim : 10 fëmijë
- Transferim në institucion tjetër: 3 fëmijë

Nga Qendra Kombëtare e viktimave të trafikimit (jopublike) kanë dalur 36 fëmijë sipas këtyre arsyeve

Sipas arsyes:

- Kthim në familje: 35 fëmijë
- Transferim në institucion tjetër 1 fëmijë

Për vitin 2016 numëri më i madh i fëmijëve të larguar nga institucionet e përkujdesit social është për arsye kthim në familje që gjithsej numërohen 144 fëmijë. Krahasuar me vitin 2015 , që numërohen 191 fëmijë të larguar nga institucionet e përkujdesit social publike për arsye se janë birësuar ,kthyer në familje ose transferuar në institucione të tjera në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve që kanë dalur nga institucionet e përkujdesit social.

7. Numri i fëmijëve që kane dale ne 2015 nga institucionet rezidenciale publike dhe jo publike (Gjithsej) sipas grupmoshes , gjinise dhe arsyes se largimit

Institucionet	Grupmosha				Arsyes se largimit		
	Gjithsej	0-3 vjeç	3-6 vjeç	6-18 vjeç	Transferim ne institucion tjetër	Biresim	Kthim në familje
INSTITUCIONE REZIDENCIALE PUBLIK PER FEMIJE(0-18)	73	25	23	25		24	49
INSTITUCIONE REZIDENCIALE JOPUBLIK PER FEMIJE(0-18)	56	12	5	39	4	6	46
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE PUBLIKE PAK	25	0	0	25	11	0	14
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE JOPUBLIKE PAK	0	0	0	0	0	0	0
QENDRA PRITESE E VIKTIMAVE TE DHUNES NE FAMILJE (Publike)	45	13	15	17	2	43	
Qendra Kombetare e viktimave te trafikimit (publik)	13	0	0	13	3	10	
QENDRA KOMBETARE E VIKTIMAVE TE TRAFIKIMIT (JoPublike)	36	4	0	32	1	0	35
Total	248	54	43	151	21	83	144

8.Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike sipas kohëzgjatjes së qëndrimit në institucion 1 vit, 1-2 vjet me shumë se 10 vjet.

Ky tregues mat numrin total të fëmijëve në strukturat rezidenciale publike dhe private sipas kohëzgjatjes së qëndrimit në to. Për vitin 2016 pranë Institucioneve të përkujdesit social publik sipas kohëzgjatjes numërohen 1 vit numërohen: 47 fëmijë , 1-2 vjet numërohen : 34 fëmijë,10 vjet numërohen: 16 fëmijë.

Në institucionet e Përkujdesit Social Jo publik numërohen: 1 vit numërohen: 81 fëmijë , 1-2 vjet numërohen : 54 fëmijë, 10 vjet numërohen: 28 fëmijë.

Në Qendra Zhvillimi Publike numërohen: 1 vit numërohen: 17 fëmijë , 1-2 vjet numërohen : 8 fëmijë, 10 vjet numërohen: 22 fëmijë.

Në Qendrën Kombëtare e viktimave të trafikimit Publike 1 vit numërohen: 4 fëmijë

Në Qendrën Kombëtare e viktimave të trafikimit JoPublike 1 vit numërohen: 32 fëmijë dhe 1-2 vjet numërohen : 1 fëmijë

8.Numi I femijeve ne institucionet rezidenciale publike sipas kohezgjatjes se qendrimit ne institucion 1 vit,1-2 vjet me shume se 10 vjet					
Institucionet	1 vit	1-2 vjet	10 vjet		
			3 vjet	5 vjet	10 vjet
INSTITUCIONE REZIDENCIALE PUBLIK PER FEMIJE(0-18)	47	34	32	28	16
INSTITUCIONE REZIDENCIALE JOPUBLIK PER FEMIJE(0-18)	81	54	72	54	28
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE PUBLIKE PAK	17	8	15	36	22
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE JOPUBLIKE PAK	0	0	0	0	0
QENDRA PRITASE E VIKTIMAVE TE DHUNES NE FAMILJE (Publike)	45	0	0	0	0
Qendra Kombetare e viktimave te trafikimit (publik)	4	0	0	1	
QENDRA KOMBETARE E VIKTIMAVE TE TRAFIKIMIT (JoPublike)	32	1	0	0	
Total	226	97	119	119	66

9.Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike, private sipas statusit ligjor të tyre i braktisur , jetim biologjik/social

Ky tregues kërkon numrin total të fëmijëve në strukturat rezidenciale publike dhe private sipas statusit të fëmijëve jetim biologjik, të braktisur, jetim sociale. Ky tregues mat fenomenin e braktisjes së fëmijëve për arsye të vdekjes së prindërve dhe të shkaqeve ekonomiko-sociale.

Për vitin 2016 numërohen në total fëmijë në institucionet e përkujdesit social rezidenciale publike dhe jopublike: 56 fëmijë jetim biologjik dhe 610 fëmijë jetim social. Për vitin 2015 numërohen në total fëmijë në institucionet e përkujdesit social rezidenciale publike dhe jopublike: 42 fëmijë jetim biologjik ,500 fëmijë jetim social dhe 63 fëmijë të braktisur.

Krahasur me vitin 2015 që numërohen 500 fëmijë jetim social, në vitin 2016 kemi një rritje të numrit të fëmijëve që janë jetim social që përfitojnë shërbim pranë institucioneve të përkujdesit social që numërohen 610 fëmijë.

Institucionet	9.Numri I femijeve ne institucionet rezidenciale publike,private sipas statusit ligjor te tyre I braktisur ,jetim	
	Jetim biologjik	Jetim social
INSTITUCIONE REZIDENCIALE PUBLIK PER FEMIJE(0-18)	27	152
INSTITUCIONE REZIDENCIALE JOPUBLIK PER FEMIJE(0-18)	15	331
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE PUBLIKE PAK	14	68
QENDRA ZHVILLIMI PER FEMIJE JOPUBLIKE PAK	0	0
QENDRA PRITESE E VIKTIMAVE TE DHUNES NE FAMILJE (Publike)	0	18
Qendra Kombetare e viktimave te trafikimit (publik)	0	5
QENDRA KOMBETARE E VIKTIMAVE TE TRAFIKIMIT (JoPublike)	0	36
Total	56	610

10. Kapaciteti, numri i fëmijëve që jetojnë dhe % e shfrytëzimit të kapacitetit të institucionit rezidencial publik dhe privat

Treguesi 10 vlerëson kapacitetin e shfrytëzimit të strukturave rezidenciale publike dhe private sipas % së shfrytëzimit.

Institucionet e Pëkuqjesit Social për Fëmijë	10. Kapaciteti, numri i fëmijëve që jetojnë dhe % e shfrytëzimit të kapacitetit të institucionit rezidencial publik dhe privat		
	INSTITUCIONE REZIDENCALE PUBLIKE PER FEMIJE (0-18 vjeç)		
	Kapaciteti	Numri i fëmijëve që jetojnë aktualisht	Përqindja e shfrytëzimit të institucionit (%)
Shtëpia e Femijes" Hana dhe Rozafa (0-6) vjeç	50	31	62%
Shtëpia e Femijes (0-6) vjeç Durrës	21	18	85%
Shtëpia e Femijes (0-6) vjeç Korçë	20	19	95%
Shtëpia e Femijes (0-3) vjeç Shkoder	35	9	25%
Shtëpia Femijes (3-6) vjeç Shkoder	30	4	13%
Shtëpia e Femijes (0-6) vjeç Vlore	30	8	26%
Shtëpia e Femijes " Zyber Hallulli" (6-18) vjeç Tirane	48	30	62%
Shtëpia e Femijes 6-18 vjeç Shkoder	70	27	38%
Shtëpia e Femijes 6-18 vjeç Sarande	40	33	82%
Totali	344	179	52%

INSTITUCIONE REZIDENCALE JOPUBLIKE PER FEMIJE (0-18 vjeç)			
INSTITUCIONET	Kapaciteti	Numri i fëmijëve që jetojnë aktualisht	Përqindja e shfrytëzimit të institucionit (%)
Fshati i femijeve " SOS" Tirane	85	94	110%
SFI " Rreze Dielli" Tirane	12	7	58%
" Fillimet e Reja" Tirane	12	11	91%
Misionaret e Bamiresise" "Nen Tereza" Elbasan	30	11	36%
" Shtepia Antonia" Oret Fatlume -Elbasan	14	10	71%
" Oret Fatlume" Elbasan	30	24	80%
Misioni Katolik" Bijat e Dashurise" Mollas Elbasan	12	7	58%
" Shtepia Orthodhokse e Shpreses" Shen Vlash" Durres	25	19	76%
" Vater e Ngrohte" Gjirokaster	15	13	86%
Komuniteti " Papa Giovanni XXIII" Shkoder	21	14	66%
" Betania" Bupq/Fushe Kruje	80	47	58%
" Shtepia e Meshires" Betesta Laç	34	16	47%
" Qendra jopublike per vajzat" Rozalba"- Gjader ,Lezhe	10	13	130%
Krahët e shqiponje Tirane	6	2	33%
Qendra per vajza Ravasko- Shkoder	15	11	73%
r femije Bishnice- Pogradec	25	20	92%
"Shprese per Boten" Marikaj	15	7	46%
"Qendra Kenedy" Korçe	10	7	70%
"Tjeter Vizion" Elbasan	10	13	20%
	461	346	72%

Aftësia e kufizuar

11.Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar sipas llojit të aftësisë së kufizuar sipas, grupmoshës,gjinisë dhe qarqeve.

Për vitin 2016 numërohen 14742 fëmijë me aftësi të kufizuar të grupmoshës 0-18 vjeç nga të cilët;

Sipas grupmoshës:

- 4148 fëmijë janë të grupmoshës 0-6 vjeç
- 7056 fëmijë janë të grupmoshës 6-15 vjeç
- 3538 fëmijë janë të grupmoshës 15-18 vjeç

Numri më i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuar e zënë fëmijë që i përkasin grupmoshës 6-15 vjeç gjithsej 7056 fëmijë dhe numri më i vogël i fëmijëve me aftësi të kufizuar e zënë fëmijë që i përkasin grupmoshës 15-18 vjeç gjithsej 3538 fëmijë.

Në vitin 2016 kemi një ulje të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithsej 14742 fëmijë , krahasuar me vitin 2015 që numërohen 16915 fëmijë me aftësi të kufizuar.

Për vitin 2015 numërohen 16915 fëmijë me aftësi të kufizuar të grupmoshës 0-18 vjeç nga të cilët;

Sipas grupmoshës:

- 4995 fëmijë 0-6 vjeç
- 8111 fëmijë 6-15 vjeç
- 3809 fëmijë 15-18 vjeç

Rajoni	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar sipas grupmoshës,gjinisë dhe qarqeve												
	Grupmosha				0- 6 vjeç			6-15 vjeç			15-18 vjeç		
	Gjithsej	0-6 vjeç	6-15 vjeç	15-18 vjeç	Gjithsej (M+F)	Gjinia		Gjithsej (M+F)	Gjinia		Gjithsej (M+F)	Gjinia	
						Femra	Meshkuj		Femra	Meshkuj		Femra	Meshkuj
Berat	804	230	343	231	230	77	153	343	126	217	231	101	130
Dibër	1102	315	508	279	315	151	164	508	208	300	279	120	159
Durrës	1845	592	949	304	592	290	302	949	379	570	304	172	132
Elbasan	2073	643	920	510	643	299	344	920	391	529	510	206	304
Fier	1397	297	726	374	297	123	174	726	277	449	374	125	249
Gjirokastër	268	43	148	77	43	17	26	148	70	78	77	30	47
Korçë	988	226	578	184	226	118	108	578	235	343	184	74	110
Kukës	655	172	326	157	172	73	99	326	149	177	157	40	117
Lezhë	697	161	332	204	161	84	77	332	111	221	204	88	116
Shkodër	1293	395	600	298	395	202	193	600	249	351	298	121	177
Tiranë	2932	953	1239	740	953	386	567	1239	531	708	740	369	371
Vlorë	688	121	387	180	121	54	67	387	149	238	180	76	104
Total	14742	4148	7056	3538	4148	1874	2274	7056	2875	4181	3538	1522	2016

Kujdestaria

Treguesit e kujdestarisë janë 4 tregues nga numri 12 deri në 15 që sipas VKM 267 si burim i të dhënave është Shërbimi Social Shtetëror.

Treguesit nga 12 deri tek 15 masin në një vit të dhëne,

- 1) numrin e familjeve kujdestare,
- 2) numrin e fëmijëve të vendosur në kujdestari sipas grupmoshave dhe gjinisë, llojit të familjes kujdestare dhe arsyeve të vendosjes së fëmijëve në kujdestari, në një vit të dhëne.
- 3) numrin e fëmijëve që nderprejnë shërbimin e kujdestarisë sipas shkakut: kthim në familjen biologjike, kthim në institucion, vendosje në familje tjetër kujdestare, kalim në jete të pavarur, birësim, etj. Të dhënat për këto tregues nuk janë raportuar asnjëherë që nga viti 2012 nga Shërbimi Social Shtetëror.

Shërbimi Social Shtetëror për vitin 2016 ka raportuar për treguesin numër 14: **Numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari pranë familjeve kujdestare që kanë lidhje gjaku me fëmijën**

Për vitin 2016 numërohen 226 fëmijë që janë të vendosur në kujdestari pranë familjeve që kanë lidhje gjaku me fëmijën, numëri më i madh i fëmijëve që janë të vendosur në kujdestari është në rajonin e Tiranës që numërohen 77 fëmijë dhe më i vogël është në rajonin e Korçës gjithsej 3 fëmijë.

Rajoni	14.Numri i femijeve te vendosur ne kujdestari prane familjeve kujdestare qe kane lidhje gjaku me femijen
Berat	12
Dibër	13
Durrës	16
Elbasan	26
Fier	18
Gjirokastrë	7
Korçë	3
Kukës	6
Lezhë	9
Shkodër	31
Tiranë	77
Vlorë	8
Total	226

